



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA

MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT

MINISTARSTVO KULTURE, OMLADINE I SPORTA/ MINISTRY OF CULTURE YOUTH AND SPORTS

NIËSIA PËR MENAXHIMIN E BURIMEVE NJERËZORE / JEDINICA ZA UPRAVLJANJE LJUDSKIM RESURSIMA /
HUMAN RESOURCES MANAGEMENT UNIT

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA
MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT
MINISTARSTVO KULTURE, OMLADINE I SPORTA/ MINISTRY OF CULTURE YOUTH AND SPORTS
Nr. Njus. 02
Shënimi Njus. 11
Nr. Prot. Viti 1255/2025
Data 12.03.2025
Nënshkrimi
Prosture

Bazuar në Ligjin e Punës, Nr. 03/L-212, Nenin 80 dhe 81, të Ligjit për Zyrtarët Publik të Republikës së Kosovës, Nr. 08/L-197, Ligji Nr. 08/L-196, për Pagat në Sektorin Publik dhe Udhëzimin Administrativ MFPT-NR. 01 /2024 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit shpall:

KONKURS

Titulli i punës: Arkitekt /e

Institucioni: Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturore (QRTK) Ferizaj

Kategoria funksionale : Krijues/e dhe përfomues/e i/e artit dhe kulturës - Profesional 1

Klasa e pozitës: K6

Koeficienti: 8

Nr. i kërkuar: 1

Data e njoftimit: 12.03.2025

Afati për aplikim: 13.03.2025 - 11.04.2025

Numri i referencës: RN00017070

Kodi: RPC0010609

I përgjegjet: Drejtorit të Qendrës Rajonale për Trashëgimi Kulturore (QRTK) Ferizaj

Vendi: Ferizaj

Detyrat dhe përgjegjësitë: Nën mbikëqyrjen e Drejtorit të Qendrës Rajonale për Trashëgimi Kulturore (QRTK) Ferizaj, kryen detyrat dhe përgjegjësitë e mëposhtme:

Detyrat dhe përgjegjësitë:

1. Është përgjegjës për planifikim, hulumtim, identifikim të aseteve të trashëgimisë kulturore;
2. Është përgjegjës për hartimin e projekteve për restaurim, konservim dhe ndërhyrje tjera, si dhe kryen mbikëqyrje të punëve restauruese/konservuese, si dhe ndërhyrjeve tjera, ne asetet e trashëgimisë kulturore - arkitektonike;
3. Udhëheqë punët në përgatitjen e dokumentacionit teknik dhe në përgatitjen e dosjeve e aseteve te trashëgimisë kulturore arkitekturore.
4. Planifikon, koordinon dhe zbaton aktivitetet ne fushën e trashëgimisë kulturore;
5. Kryen edhe punë tjera në pajtim me qëllimin e vendit të punës të cilat mund të kërkohen nga ana e udhëheqësit.

Kriteret e përgjithshme për pranimin në detyrë të zyrtares/it publik

Kriteret e përgjithshme që një person duhet t'i plotësojë në procedurën e rekrutimit, për t'u pranuar si zyrtar publik në cilëndo kategori apo nivel, janë:

- 1.1. të jetë shtetasi Republikës së Kosovës;
- 1.2. të ketë zotësi të plotë veprimi, sipas legjislacionit në fuqi;
- 1.3. të zotërojë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- 1.4. të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse;
- 1.5. të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje;
- 1.6. të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik;
- 1.7. të ketë arsimin, përvojën e punës profesionale dhe/apo aftësitë e kërkuara për pozitën, kategorinë, klasën apo grupin përkatës; dhe
- 1.8. të kaloj me sukses procedurat e pranimit të përcaktuara në këtë ligj.

Kërkesat e përgjithshme formale:

- a) **Arsimimi i kërkuar:** Diplomë e studimeve themelore universitare të fushës së arkitekturës.
- b) **Kërkesat specifike:** Certifikata, licenca kur kërkohen me legjislacionin në fuqi.
- c) **Përvoja e punës e kërkuar:** Së paku dy (2) vjet përvojë pune profesionale.

Dokumentet që duhet të dorëzohen si pjesë e aplikimit dhe mënyrën e dorëzimit të tyre

- Kopjen e letërnjoftimit/pasaportës/certifikatës së shtetësisë së Republikës së Kosovës.
- Kopjen e diplomës të kërkuar me konkurs të lëshuar nga institucionet arsimore të Republikës së Kosovës. Nëse diploma është fituar jashtë vendit, vërtetimin e nostrifikimit të diplomës së fituar apo aktin që dëshmon se diploma e fituar është në procedurë të nostrifikimit, me kusht që nostrifikimi i diplomës të dorëzohet deri në momentin e nënshkrimit të aktit për emërim në pozitë;
- Kopjet e dëshmisë së punësimit(vërtetim/kontratë) të lëshuar nga institucioni përkatës i punësimit për përvojën e punës, që përcakton pozitën e punës si dhe kohëzgjatjen e angazhimit në atë pozitë. Dëshmisë e punësimit jashtë institucioneve publike duhet të mbështet së paku njëra nga dëshmitë si në vijim: pasqyra e pagesave në fondin e kursimeve pensionale apo pasqyra e pagesave të obligimeve tatimore në përputhje me legjislacionin tatimor për të ardhurat personal.
- Dëshmi që nuk ka në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik (Kandidatët që janë të punësuar apo kanë qenë të punësuar në institucione publike).
- Dëshmitë e trajnimeve profesionale të ndjekura apo trajnimeve që aplikuesi i ka realizuar në cilësinë e trajnuesit.
- Kopjet e dokumenteve tjera që provojnë plotësimin e kushteve për aplikim të përcaktuara në shpalljen e rekrutimit dhe të deklaruara në aplikacion.

Dëshmitë që nuk kërkohen gjatë aplikimit, por në fazën e verifikimit para emërimit

- Certifikatë mbi dënimet penale origjinale e lëshuar nga gjykata përmes së cilës dëshmohet se nuk është i/e dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje, jo më të vjetër se(6) muaj nga data e lëshimit.
- Dëshmi se kandidati është i aftë në pikëpamje shëndetësore.
- Dëshmi përkatëse se kandidati ka zotësi të plotë për të vepruar.

Kërkesat (Njohuritë, aftësitë dhe cilësitë) e përgjithshme të nevojshme

1. Aftësi të arsyetimit logjik dhe analizës;
2. Aftësi për të bërë gjykime profesionale të pavarura dhe për të ushtruar diskrecion mbi çështjet dhe për të dhënë një kontribut të rëndësishëm në zhvillimin dhe zbatimin e politikave;
3. Shkathësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;
4. Shkathësi kompjuterike në aplikacione të programeve (Word, Exel, Power Point, Access) si dhe programeve Cad;
5. Aftësi komunikimi dhe ndikim personal, përfshirë aftësi për të përfaqësuar.

Procedura e konkurimit: Konkursi është i hapur për të gjithë kandidatët e interesuar

Kohëzgjatja e emërimit: Emërimi është pa afat të caktuar.

INFORMATË E PËRGJITHSHME PËR TË GJITHË KANDIDATËT

Data e njoftimit për aplikim në webfaqen unike të procedurave të konkurimit <https://konkursi.rks-gov.net>, kurse data e aplikimit janë , nga data 13.03.2025, deri me datë 11.04.2025.

Përveç web faqes unike të procedurave të konkurimit, konkursi publikohet edhe në Web faqen e MKRS-se.

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, ofron mundësi të barabarta punësimi për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

Komunitetet jo shumicë dhe pjesëtarët e tyre, personat me aftësi të kufizuar dhe gjinia më pak e përfaqësuar kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në Shërbimin Civil të Kosovës, siç specifikohet në LZP”;

Paraqitja e kërkesave: Aplikacioni merret në ueb-faqen <http://www.mkrs-ks.org/> dhe dorëzohet në Zyrën 029, të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Sheshi “Nëna Terezë” Nr. 44.

“Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen”.

Kandidati përmes aplikacionit deklaron dhe mban përgjegjësi për vërtetësinë e të gjitha dokumenteve të dorëzuara siç kërkohen nga shpallja e procedurës së rekrutimit.

Deklarimi i rrejshëm sipas këtij neni paraqet shkas për përjashtim nga procedura e rekrutimit.